



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E METROLOGJISË SHKENCORE DHE INDUSTRIALE
SEKTORI I VOLUMIT, RRJEDHJEVE DHE KIMISË

Nr. 1885/prot.

Tiranë, më 08.10.2024

Lënda: Mbi kërkesën për informacion

Në përgjigje të kërkesës Suaj, më datë 07.10.2024 "Kërkesë për informacion", protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) me nr.1885 prot, datë 08.10.2024, Ju bëjmë me dije si më poshtë.

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", Pjesa XII e VKM nr. 463, datë 18.7.2012 "Për një shtesë në vendimin nr. 1351, datë 3.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike metrologjike të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara" dhe Urdhërit të Ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 219, datë 21.09.2022 "Për miratimin e rregullores për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara", Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), ofron shërbimin e kalibrimit të instrumentit matës, analizues fryme.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, intervali i verifikimit/kalibrimit periodik të instrumentit matës, analizues fryme (alkoolmetër) është çdo 6 (gjashtë) muaj.

Instrumenti matës, analizues fryme, tip CD , me numër serial në përdorim nga kalibruar për herë të fundit (me kërkesë për të cilin Ju kërkonti informacion, është nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, më datë 14.12.2023 dhe është lëshuar certifikata e kalibrimit me nr. LK- në datë 19.12.2023.

Ky instrument matës, referuar legjislacionit në fuqi, deri në datë 13.06.2024, ka qenë brenda intervalit të vlefshmërisë së kontrollit të fundit të kryer nga DPM. Për sa më sipër, pas kësaj datë

dhe deri më sot, pranë DPM nuk është paraqitur kërkesë nga _____ për kalibrimin e instrumentit matës, analizues fryme, të sipërcituar.

Gjithashtu, Ju informojmë se shërbimi i kalibrimit të instrumenteve matëse kryhet me kërkesë të përdoruesit të instrumentit matës.

Të nderuar, Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama

